

Mbrojtja Konsumatorit dhe Siguria Ushqimore

Praktikat dhe kërkesat e BE-së për Edukimin e të Rinjve

INFORMACION MBI ETIKETIMIN E PRODUKTEVE USHQIMORE TË PAKETUARA

EDUKIMI I TE RINJVE PER LEXIMIN E ETIKETAVE TE PRODUKTEVE USHQIMORE.

Baza ligjore për etiketimin është Vendimi i Këshillit të Ministrave VKM. 434, datë 11.7.2018 “Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit” për ushqimet e paketuara që shiten në Shqipëri.

Ushqimet e paketuara cilësohen si:

“çdo njësi e veçantë e produktit ushqimor, e prezantuar si e tillë te konsumatori i fundit dhe te ushqimi social, që përbëhet si nga produkti ushqimor, ashtu edhe nga ambalazhi, në të cilin ai është vendosur përpara se të ofrohet për shitje, pavarësisht faktit nëse ky ambalazh e mbështjell produktin ushqimor në mënyrë të plotë ose të pjesshme, por, në të gjitha rastet, në mënyrë të atillë që përmbajtja ushqimore mund të mos ndryshohet pa e hapur ose ndërruar ambalazhin. Produkti ushqimor i ambalazhuar paraprakisht nuk përfshin produktet ushqimore të paketuara në ambientet e shitjes, me kërkesë të konsumatorit apo produktet e ambalazuara paraprakisht për shitje direkte.”

Sigurimi i informacionit të detajuar të ushqimit u siguron konsumatorëve informacionin kryesor mbi natyrën dhe karakteristikat e një produkti ushqimor dhe u mundëson atyre të bëjnë një zgjedhje të informuar kur blejnë ushqim.

Kërkesa të Përgjithshme

Informacioni për ushqimin duhet të jetë i saktë, i qartë dhe i lehtë për t’u kuptuar për konsumatorin. Ai nuk duhet të jetë çorientues, veçanërisht:

- a Sa i përket karakteristikave të ushqimit dhe, veçanërisht, për natyrën, identitetin, vetitë, përbërjen, sasinë, qëndrueshmërinë, vendin e origjinës ose origjinën, mënyrën e prodhimit ose prodhimin;
- b Duke i atribuar ushqimit, efekte ose veti të cilat ai nuk i ka;
- c Duke sugjeruar që ushqimi ka karakteristika të veçanta kur në fakt, të gjitha ushqimet e ngjashme kanë karakteristika të tilla, veçanërisht duke theksuar në mënyrë specifike praninë ose mungesën e përbërësve të caktuar dhe/ose lëndëve ushqyese;

d Duke sugjeruar, me anë të pamjes, përshkrimit ose paraqitjes vizuale, praninë e një ushqimi ose përbërësi të veçantë, ndërsa në realitet një komponent i pranishëm natyrshëm ose një përbërës i përdorur normalisht në atë ushqim është zëvendësuar me një komponent të ndryshëm ose një përbërës të ndryshëm.

Në Shqipëri, informacioni ushqimor duhet të jetë në gjuhën shqipe. Përveçse në gjuhë shqipe, informacioni mund të jepet edhe në gjuhë të tjera.

DISPONUESHMËRIA DHE VENDOSJA E INFORMACIONIT TË DETYRUESHËM TË USHQIMIT

Informacioni ushqimor i detyrueshëm shënohet në një vend të dallueshëm, në mënyrë të tillë që të jetë lehtësisht i dukshëm, qartësisht i lexueshëm dhe të mos fshihet. Në asnjë mënyrë ai nuk duhet të jetë i fshehur, i errësuar, të kufizohet apo të ndërpritet nga ndonjë material tjetër i shkruar, imazh apo element ndërhyrës.

Informacioni ushqimor vullnetar nuk duhet të vendoset, nëse dëmton hapësirën e disponueshme për informacionin ushqimor të detyrueshëm.

MADHËSIA MINIMALE E SHKRONJAVE

Informacioni i detyrueshëm printohet në paketim ose në etiketë, në mënyrë të tillë që të garantohet lexueshmëria e qartë, me shkronja me madhësi shkrimi ku lartësia x është e barabartë ose më e madhe se 1.2 mm, siç përcaktohet në Shtojcën IV VKM 434/2018.

Në rastin e paketimit ose të enëve me sipërfaqe totale më të vogël se 80 cm², lartësia x e madhësisë së shkrimit, është e barabartë ose më e madhe se 0,9 mm.



SHITJA NË DISTANCË

Në mënyrë që të sigurohet dhënia e informacionit për ushqimin, është e nevojshme të merren parasysh të gjitha mënyrat e furnizimit të ushqimit për konsumatorët dhe VKM 434/2018 përfshin referenca për ushqimin i cili shitet me anë të komunikimit në distancë, p.sh. shitjet në internet.

Çdo ushqim i furnizuar përmes shitjes në distancë duhet të plotësojë të njëjtat kërkesa informacioni si ushqimi i shitur në një mjedis fizik, p.sh. dyqane.

Legjislacioni sqaron se në rastin e shitjes në distancë të ushqimit të paketuar, informacioni i detyrueshëm i ushqimit duhet të jetë i disponueshëm përpara sesa të kryhet blerja, me përjashtim të datës së jetëgjatësisë minimale”të përdoret deri më”.

Përkufizimi i "informacionit të detyrueshëm të ushqimit" përfshin të gjithë informacionin që duhet t'i sigurohet konsumatorit përfundimtar nga Ligji Shqiptar për Ushqimin* në përgjithësi dhe nuk kufizohet vetëm me VKM 434/2018. Informacioni i detyrueshëm duhet të shfaqet në materialin që mbështet shitjen në distance ose të sigurohet përmes mjeteve të tjera të përshtatshme të identifikuar qartë nga operatori i biznesit të ushqimit. Kur përdoren mjete të tjera, të përshtatshme, informacioni ushqimor i detyrueshëm jepet pa vendosjen e kostove shtesë për konsumatorët nga biznesi ushqimor; Të gjitha të dhënat e detyrueshme duhet të jenë të disponueshme në momentin e dorëzimit.

Në rastin e produkteve ushqimore jo të paraambalazuara, të ofruara për shitje nëpërmjet komunikimit në distancë, duhet të ofrohet informacion mbi alergjenëtmbështetur nga programet paraprake që përfshijnë praktikatat e mira të higjenës, pastrimit dhe kanalizimeve, mirë përcaktimin dhe ndarjen e zonave të përpunimit, kontrollin e furnizimit, ruajtjes, shpërndarjes dhe transportit, higjenën dhe përuethmërinë e personelit për të punuar - të gjitha kushtet themelore dhe hapat e nevojshme për ruajtjen dhe përpunimin e ushqimit në përputhje me kërkesat e higjeno sanitare.

INFORMACION I DETYRUESHËM

Për ushqimet e paketuara, informacioni i mëposhtëm i detyrueshëm duhet të shfaqet drejtpërdrejt në paketim ose në një etiketë të bashkangjitur:

1. Emri i produktit ushqimor;
2. Lista e përbërësve;
3. Çdo përbërës ose lëndë ndihmëse e përpunimit renditur në Shtojcën II, VKM 434/2018 apo që vjen nga një substancë ose produkt i renditur në Shtojcën II, VKM 434/2018, që shkakton alergji ose intoleranca, i përdorur në prodhimin ose përpunimin e produktit ushqimor dhe që është ende i pranishëm në produktin përfundimtar edhe nëse në formë të ndryshuar;
4. Sasia e përbërësve ose e kategorive të caktuara të përbërësve sipas rendit zbritës;
5. Sasia neto e produktit ushqimor;
6. Data e jetëgjatësisë minimale ose “të përdoret përpara” datës;
7. Kushtet e veçanta të ruajtjes dhe/ose kushtet e përdorimit;

8. Emri ose emri tregtar dhe adresa e operatorit të biznesit ushqimor, të
9. Shteti i origjinës ose vendi i prejardhjes, kur parashikohet në nenin 26;
10. Udhëzimet e përdorimit, kur, në mungesë të tyre, përdorimi i duhur i produktit ushqimor do të ishte i vështirë;
11. Për pijet me mbi 1.2% të vëllimit me alkool*, fortësinë aktuale alkoolike për vëllim;
12. Deklaratën e vlerave ushqyese.

Mandatory food labelling requirements	Voluntary* information sometimes provided
Name	Nutrition information (if no claims made)
List of ingredients	Nutrition signposting
Quantity of certain ingredients (e.g. pork (10%))	Guideline Daily Amounts
Net quantity (weights & measures)	Claims such as 'no artificial additives'
Date of minimum durability ('best before' or 'use by')	Graphical and pictorial information
The name and address of manufacturer/ packer/ seller	Vegetarian/ vegan labelling
Place of origin (if failure to do so might mislead)	May contain (e.g. nuts) labelling

* Based on information provided voluntarily in the UK

1. EMRI I PRODUKTIT USHQIMOR

Emri i produktit ushqimor duhet të tregohet në mënyrë që të informojë blerësin për natyrën e vërtetë të produktit. Legjislacioni kërkon që kur një produkt ka një emër tregtar, atëherë ai duhet të përdoret. Emri tregtar është emri i përcaktuar në legjislacioni për produktet që duhet të plotësojnë specifikime të veçanta.

Nëse një emër tregtar nuk ekziston, mund të përdoret një emër i zakonshëm, domethënë një emër që është pranuar nga konsumatorët pa pasur nevojë për shpjegime të mëtejshme siç është "byrek". Në rrethana të caktuara, për të shmangur konfuzionin, një përshkrim mund të kërkohej të tregojë natyrën e vërtetë të produktit dhe ta dallojë atë nga ushqimet e tjera. Ky informacion duhet të shfaqet në afërsi të emrit të ushqimit.

Përdorimi i emrit të markës, emrit të shitjes, emrit të zbukuruar ose markës tregtare përdoret së bashku me emrin tregtar ose të zakonshëm të produktit.

Veçoritë e Detyrueshme shoqëruese të emrit të produktit ushqimor

Trajtimet

Emri i produktit ushqimor përfshin ose shoqërohet nga veçoritë e tilla, si: gjendja fizike e produktit ushqimor ose trajtimi specifik që ka pësuar (për shembull, pluhur, i ngrirë, ngrirje e thellë, i përqendruar, i tymosur) në të gjitha ato raste kur mosdhënia e këtij informacioni mund të jetë çorientues për blerësin.

Ushqimet e Shkrira

Në rastin e produkteve ushqimore që janë ngrirë para shitjes dhe të cilat janë shitur të shkrira, emri i produktit ushqimor shoqërohet nga emërtimi “i shkrirë”.

Kjo kërkesë nuk zbatohet për sa më poshtë:

- (a) Përbërësit e pranishëm në produktin përfundimtar, dmth. përbërësit të cilët janë ngrirë dhe shkrirë para se të përfshihen në produktin përfundimtar;
- (b) Ushqimet për të cilat ngrirja është një hap teknologjikisht i nevojshëm i procesit të prodhimit;
- (c) Ushqimet për të cilat shkrirja nuk ka ndikim negativ në sigurinë ose cilësinë e ushqimit

Ushqimet e Trajtuara me Rrezatim

Produktet ushqimore të trajtuara me rrezatim jonizues mbajnë një nga deklaratimet e mëposhtme: “I parrezatuar” ose “trajtuar me rrezatim jonizues” dhe deklarime të tjera të shprehura në udhëzimin nr. 4, datë 14.5.2014, “Mbi produktet ushqimore dhe ingredientët ushqimorë të trajtuar me rrezatim jonizues”.

Përbërësit Zëvendësues

Në rastin e ushqimeve në të cilat një komponent ose përbërës që konsumatorët presin të përdoren normalisht ose që janë të pranishëm natyrshëm është zëvendësuar me një komponent ose përbërës të ndryshëm, etiketimi duhet të ketë - përveç listës së përbërësve - një tregues të qartë të komponentit ose përbërësit që është përdorur për zëvendësimin e pjesshëm ose të plotë:

- (a) Në afërsi të emrit të produktit; dhe;
- (b) Përdorimi i një madhësie fonti e cila ka një lartësi x prej të paktën 75% të lartësisë x të emrit të produktit dhe i cili nuk është më i vogël se madhësia minimale e shkronjave e përcaktuar në legjislacion

2. LISTA E PËRBËRËSVE

Ushqimet e paraambalazuara me dy ose më shumë përbërës duhet të kenë një listë të të gjithë përbërësve të përdorur në prodhimin e tij. Një numër i kufizuar ushqimesh përjashtohen nga ky detyrim (shih Shtojcën I të kësaj broshure). Lista e përbërësve duhet të kryesohet ose paraprihet nga një titull i cili përbëhet ose përfshin fjalën "përbërës". Të gjithë përbërësit e produktit ushqimor, duhet të renditen në rendin zbritës të peshës, siç janë regjistruar në kohën e përdorimit të tyre në fazën e prodhimit të produktit ushqimor. Emri i një përbërësi duhet të jetë emri i tyre ligjor. Në mungesë të një emri ligjor, duhet të përdoret një emër i zakonshëm ose një 'emër përshkrues' (shih seksionin 1 për më shumë detaje). Emri i përbërësit të përdorur duhet të jetë mjaft specifik për të përshkruar me saktësi përbërësin e përdorur. Në raste të caktuara, përdorimi i një emri kategorie (të renditur në Aneksin VII të VKM Nr. 434/2018) lejohet në vend të një emri specifik, p.sh. erëzat që nuk e kalojnë 2% të peshës së ushqimit mund të tregohen si 'erëza' ose 'erëza të përziera' në vend që të përmenden erëzat individualisht në listën e përbërësve.

Elementët e një përbërësi me disa përbërës duhet të deklarohen në listën e përbërësve, për shembull, lista e përbërësve të një tiramisù-je të përgatitur duke përdorur një pandispanjë, duhet të detajojë përbërësit e pandispanjës dhe jo vetëm të tregojë "pandispanja" në listën e përbërësve.

Të gjithë përbërësit e pranishëm në formën e nanomaterialeve të projektuar duhet të tregohen qartë në listën e përbërësve. Emrat e këtyre përbërësve do të pasohen me fjalën "nano" në kllapa.

Aditivët që kryejnë funksione teknologjike në ushqimin përfundimtar duhet të deklarohen në listën e përbërësve duke treguar së pari kategorinë (funksioni) i aditivit i ndjekur menjëherë nga emri specifik i aditivit ose i tij Numri E, p.sh. Glutamati i monosodiumit përdoret shpesh si një përforcues i shijes në ushqim dhe duhet të deklarohet në listën e përbërësve si: Përmirësues i aromës: E621 ose Përmirësues i aromës: Glutamat monosodiumi (shiko shembullin më poshtë që tregon aditivët e deklaruar me kategorinë e tyre në përbërësit e listës).



3. ALERGJENËT/INTOLERANCAT

Bazuar në rishikimin shkencor, BE -ja ka identifikuar ushqime të caktuara të cilat konsiderohen si alergjenë të zakonshëm ushqimorë ose ushqime ndaj të cilave individët mund të ketë intolerancë.

Shih Shtojcën II të këtij dokumenti për listen të alergeneve. Aty ku identifikohet përdorimi i ndonjë nga këto 14 substancave si përbërës në një ushqim, ato duhet të tregohen në një mënyrë të veçantë në etiketë:

- (a) Ato duhet të tregohen në listën e përbërësve me një referencë të qartë për emrin e substancës ose produktit të listuar në Aneksin II të VKM 434/2018.
- (b) Emri i substancës ose produktit duhet të theksohet përmes një mënyre shkrimi që e dallon qartë atë nga pjesa tjetër në listën e përbërësve, për shembull me anë të shkrimit, stilit ose ngjyrës së sfondit.

Indikimi i alergeneve në një "kuti alergjeni" ose paneli alergjen nuk lejohet sipas VKM 434/2018.

Aty ku produkti nuk kërkon një listë të përbërësve, treguesi i alergjenit duhet alergjenit. Më poshtë janë shembuj të mënyrës se si mund të evidentohen allergenët në listën e përbërësve.

INGREDIENTS
Water, Carrots, Onions, Red Lentils (4.5%) Potatoes, Cauliflower, Leeks, Peas, Cornflower, Wheat flour, Cream (milk), Yeast Extract, Concentrated Tomato Paste, Garlic, Sugar, Celery Seed, Sunflower Oil, Herb and Spice, White Pepper, Parsley
ALLERGY ADVICE
For allergens, see ingredients in bold


4.

*Deklarimi
Sasior i
Përbërësve*

Në rrethana të caktuara, është e nevojshme të tregoni në

etiketë sasinë e një përbërësi i cili përdoret në prodhimin ose përgatitjen e një ushqimi. Sasia llogaritet në fazën e tasit të përzierjes dhe duhet të deklarohet në përqindje. Duhet të shfaqet në ose pranë emrit të ushqimit ose të jetë në listën e përbërësve. Kjo njihet si deklarata sasimore e përbërësve, e cila është krijuar për të ndihmuar konsumatorët të krahasojnë përbërjen e produkteve të ngjashme. Për shembull, sasia e një përbërësi si përqindje duhet të deklarohet në etiketë ku përbërësi është:

- I përfshirë në emrin e ushqimit të tillë si 'Qofte me mish pule' ku sasia e mishit të pulës duhet të tregohet
- Lidhur me emrin e ushqimit të tillë si 'byrek me mish' ku përmbajtja e mishit duhet të përcaktohet ose
- Theksuar me fjalë, p.sh. 'Me gjalpë' ose me përdorimin e fotografive ose grafikëve



5. **PESHA NETO**

Të gjitha ushqimet e paketuara, me përjashtime të kufizuara, duhet të etiketohen me informacione mbi sasinë neto të ushqimeve, si pesha ose vëllimi i saj, i cili nuk përfshin materialin e paketimit. Kur një ushqim i ngurtë vendoset në një mjedis të lëngshëm, duhet të deklarohet pesha neto e kulluar e produktit ushqimor. Sasia neto duhet të shprehet duke përdorur sistemin metrik, si litra ose mililitra për lëngje ose kilogramë dhe gramë për produkte solide.

6. **TË PËRDORET PËRPARA OSE TË PËRDORET DERI MË**

Data e jetëgjatësisë minimale, ose data "të përdoret përpara...", është data deri në të cilën një produkt ushqimor ruan vetitë e tij specifike p.sh. shijen, aromën, pamjen, cilësitë specifike që lidhen me produktin, përmbajtjen e vitaminave, etj. kur produkti është ruajtur në mënyrën e duhur dhe paketimi nuk është hapur.

Përgjithësisht datimi “të përdoret përpara” përdoret për produktet ushqimore si ushqimet e konservuara, të thata, të ngrira ose të ambjentit, dhe është një çështje cilësie më shumë sesa sigurie.

Megjithatë data “të përdoret deri më” është e nevojshme për ushqime të cilat, nga pikëpamja mikrobiologjike, kanë shkallë të lartë të prishjes, dhe si rrjedhojë, pas një periudhe të shkurtër kohe, paraqesin një rrezik të menjëhershëm për shëndetin e konsumatorit. Ushqimet me afat të shkurtër ruajtjeje që kërkojnë ftohje bëjnë pjesë në këtë kategori, si qumështi, mishi i grirë, peshku dhe sallatat e gatshme. Pasi të ketë kaluar data e “të përdoret deri më”, një ushqim nuk duhet të shitet pasi konsiderohet i pasigurt në përputhje me Ligjin Nr. 9863 për Ushqimin, datë 28.1.20085.

Shumica e ushqimeve duhet të kenë datën të shënuar, megjithatë, ka disa përjashtime, si p.sh. data e jetëgjatësisë minimale nuk është e nevojshme për pije me vëllim më të madh se 10% të alkoolit, uthull ose kripë (shih Aneksin X të VKM 434/2018 për listën e plotë të përjashtimeve).

Kur është e nevojshme, data “të përdoret përpara” duhet të pasohet nga një përshkrim i kushteve të ruajtjes të cilat duhet të respektohen nëse produkti duhet të ruhet për periudhën e specifikuar. Produktet të cilat mbajnë një datë “të përdoret deri më” duhet të ndjekin udhëzuesin me një përshkrim të kushteve të

ruajtjes që duhet të respektohen, si për shembull të ruhet në frigorifer.

Ushqimet që janë të ngrira duhet të mbajnë një datë “të përdoret përpara” dhe përveç kësaj, mishi i ngrirë,

përgatitjet e ngrira të mishit dhe produktet e ngrira të papërpunuara të peshkut duhet gjithashtu të tregojnë 'ngrirë më...' dhe përfshijnë në këtë tregues ditën, muajin dhe vitin që produkti ushqimor është ngrirë.



7. VENDI I ORIGJINËS OSE VENDI I PREJARDHJES

1. Deklarimi i shtetit të origjinës ose i vendit të prejardhjes është i detyrueshëm:
 - a) Kur mosdeklarimi i tyre mund të çorientojë konsumatorin në lidhje me vendin e saktë të origjinës ose vendin e saktë të prejardhjes së produktit ushqimor, veçanërisht nëse informacioni që shoqëron produktin ose etiketa, në tërësi, do të nënkuptonte vend të ndryshëm origjine apo vend të ndryshëm prejardhjeje;
 - b) Për mishin që përfshihet në kodet (CN) të Nomenklaturës së Kombinuar, të renditur në shtojcën XI;
 - c) Për llojet e mishit të ndryshme nga mishi i viçit dhe ato të përmendura në shkronjën “b”, të pikës 1;
 - ç) Për qumështin;
 - d) Për qumështin e përdorur si përbërës në produktet e bulmetit;
 - dh) Për produktet ushqimore të papërpunuara;
 - e) Për produktet me një përbërës të vetëm; ë) Për përbërësit që përfaqësojnë mbi 50% të produktit ushqimor;
 - f) Për përdorimin e mishit si përbërës.
2. Në rastin kur vendi i origjinës ose vendi i prejardhjes së një produkti ushqimor deklarohet dhe nuk është i njëjtë me atë të përbërësit kryesor:
 - a) Duhet të deklarohet, gjithashtu, edhe vendi i origjinës ose vendi i prejardhjes së përbërësit kryesor;
 - b) Duhet të deklarohet që vendi i origjinës ose vendi i prejardhjes së përbërësit kryesor është i ndryshëm nga ai i produktit ushqimor;
 - c) Në rastet kur produkti ushqimor importohet dhe ambalazhohet në vendin tonë, duhet të shënohet vendi i origjinës ose vendi i prejardhjes së produktit ushqimor dhe emri i operatorit të biznesit ushqimor që e ka ambalazhuar.

8. UDHËZIMET E PËRDORIMIT

Udhëzimet e përdorimit të një produkti ushqimor paraqiten në mënyrë të tillë që të mundësohet

9. DEKLARATA E VLERAVE USHQYESE

Sipas VKM nr. 434/2018 "Për Etiketimin e Ushqimit dhe Informimin e Konsumatori" hyri në fuqi nga data 19.07.2020, një deklaratë e vlerave ushqimore bëhet e detyrueshme për ushqimet e paketuara nga 19 Korriku 2020. Lista e ushqimeve të cilat përjashtohen nga kërkesa e detyrueshme për të siguruar informacion ushqyes mund të gjendet në Shtojcën III të këtij dokumenti. Ushqimet që ofrojnë informacione ushqimore në baza vullnetare ose që paraqesin një deklaram për shëndetin në etiketë, duhet të sigurojnë informacionin ushqimor në formatin e përshkruar të përcaktuar në VKM 434/2018.

Informacioni i Detyrueshëm

Informacioni ushqimor i një produkti ushqimor i cili duhet të deklarohet është:

- (a) Vlera e energjisë; dhe
- (b) Sasi të yndyrës, të ngopura, karbohidratet, sheqernat, proteina dhe kripë

Sipas rastit, shumë pranë deklaratës së vlerave ushqyese mund të paraqitet një deklaratë që tregon se përmbajtja e kripës është ekskluzivisht për shkak të pranisë në mënyrë të natyrshme të natriumit.

Në rastet kur vlera e energjisë ose sasia e vlerave ushqyese në një produkt është e papërfillshme, informacioni për këto elemente mund të zëvendësohet me deklaratën: "Përmban sasi të papërfillshme të ..." dhe të paraqitet pranë deklaratës së vlerave ushqyese.



Nutrition Typical values (cooked as per instructions)	per 100g	per 1/4 pack	% adult GDA, 1/4 pack	GDA children (5-10 yrs)
Energy kJ	1007	2014		1800
Energy kcal	241	482		24g
Protein	8.4g	16.8g	24.1%	220g
Carbohydrate	20.6g	41.2g	17.9%	85g
of which sugars	1.8g	3.6g	4.0%	-
of which starch	18.8g	37.6g		70g
Fat	13.7g	27.4g	39.1%	20g
of which saturates	5.7g	11.4g	57.0%	
mono-unsaturates	5.9g	11.8g		
polyunsaturates	1.5g	3.0g		
Fibre	0.9g	1.8g		
Salt	0.50g	1.00g	7.5%	
of which sodium	0.20g	0.40g	16.7%	

GDA = Adult Guideline Daily Amounts are based on a diet of 2500 kcal per day for a 70kg average male. GDAs are guidelines and personal requirements vary depending on age, gender, weight and activity.

10. Kërkesat Shtesë për Etiketimin

Ushqimet e mëposhtme duhet të përmbajnë informacion të detyrueshëm plotësues në etiketë (detajet janë përcaktuar në Shtojcën IV të këtij dokumenti):

- Ushqimet e paketuara në gaze të caktuara
- Ushqimet që përmbajnë ëmbëlsues
- Ushqime që përmbajnë acid glicirrhizinik ose kripë amoniake të tij
- Pije me përmbajtje të lartë kafeine ose ushqime me kafeinë shtesë
- Ushqimet me fitosterole të shtuara, estere fitosterole, fitostanole ose estere fitostanol
- Mishi i ngrirë, produktet e ngrira me përbërje mishi dhe produktet e ngrira të papërpunuara të peshkut
- Ushqimet që përmbajnë ngjyues të verdhë sunset (E 110), e verdhë quinoline (E 104), carmoisine (E 122), ngjyues alura red (E 129), tartrazine (E 102) ngjyues ponso 4R (E 124)

11. Ushqimet që Përjashtohen nga Detyrimi për Deklarim në Listën e Përbërësve

1. Frutat dhe perimet e freskëta, përfshirë patatet, të cilat nuk janë qëruar, prerë ose trajtuar
2. Uji i gazuar, përshkrimi i të cilit tregon se është i gazuar;
3. Uthullat e fermentuara që rrjedhin ekskluzivisht nga një produkt i vetëm bazë, me kusht që të mos jetë shtuar asnjë përbërës tjetër
4. Djathë, gjalpë, qumësht dhe krem i fermentuar, të cilëve nuk u është shtuar asnjë përbërës përveç produkteve laktike, enzimeve ushqimore dhe kulturave të mikroorganizmave thelbësore për prodhimin, ose në rastin e djathit të ndryshëm nga djathi i freskët dhe djathi i përpunuar, kripa e nevojshme për prodhimin e tij
5. Ushqimet e përbëra nga një përbërës i vetëm, ku:
 - (i) Emri i ushqimit është identik me emrin e përbërësit; ose
 - (ii) Emri i ushqimit mundëson që natyra e përbërësit të identifikohet qartë

12. Produktet Ushqimore të Cilat Përjashtohen nga Kërkesa e Deklaratës së Detyrueshme të Vlerave Ushqimore

1. Produktet e papërpunuara që përmbajnë një përbërës të vetëm ose kategori përbërësish;

2. Produktet e përpunuara të cilat i janë nënshtruar vetëm maturimit dhe që përmba-jnë një përbërës të vetëm ose kategori përbërësish;
3. Ujërat e destinuara për konsum njerëzor, përfshirë ato ku përbërësit e vetëm shtesë janë dyoksidi i karbonit dhe/ose substancat aromatizuese;
4. Barërat, erëzat ose përzierjet e tyre;
5. Kripa dhe zëvendësuesit e kripës;
6. Ëmbëlsuesit artificialë;
7. Ekstraktet e kafes dhe çikores, kokrrat e kafes të plota ose të shtypura dhe të plota ose kokrrat e kafes të dekafeinizuara dhe të bluara;
8. Infusionet bimore dhe të frutave, çaji, çaji i dekafeinizuar, çaji i çastit ose i tretshëm ose ekstrakti i çajit, çaji i dekafeinizuar, i çastit ose i tretshëm, që nuk përmbajnë përbërës të tjerë shtesë, përveç substancave aromatizuese, të cilat nuk modifikojnë vlerën ushqyese të çajit;
9. Uthullat e fermentuara dhe zëvendësuesit e uthullës, përfshirë ato ku të vetmit përbërës të shtuar janë substancat aromatizuese;
10. Substancat aromatizuese;
11. Aditivët ushqimorë;
12. Lëndët ndihmëse të përpunimit;
13. Enzimat ushqimore;
14. Xhelatina;
15. Mjedisi përbërës i reçelrave;
16. Majaja;
17. Çamçakëzi;
18. Produktet ushqimore në paketim ose kontejnerë, sipërfaqja më e madhe e të cilave është më pak se 25 cm²;
19. Produkte ushqimore, përfshirë produktet ushqimore të prodhuara me dorë, të ofruara drejtpërdrejt në sasi të vogla nga prodhuesi te konsumatori i fundit ose te qendrat vendore të shitjeve me pakicë të cilat ua ofrojnë drejtpërdrejt konsumatorëve të fundit.



Përgatitur:

Valbona PALUKA

Eksperte Mbrojtjes Konsumatorit dhe Siguria Ushqimore